VENDIM
Nr.3, datë 25.1.2005

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR AKTIVITETIN E IMPORTIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË GSA SHPK

Në mbështetje të neneve 13 pika 1 germa dh, 15 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nenit 5 pika 1 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 "Rregullorja për procedurat e licencimit", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.1.2005, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria Grupi i Sistemeve Automatike (GSA sh.p.k.) për marrje të licencës për aktivitetin e importit të energjisë elektrike ,

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës shoqërisë Grupi i Sistemeve Automatike, për aktivitetin e importit të energjisë elektrike me afat 1 vit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema